



EQUAL RIGHTS FOR ALL COALITION

NGRITJA E KAPACITETEVE GJUHËSORE TË NËNPUNËSVE CIVILË KOMUNALË

Nëntor, 2018



European
Union
Kosovo

Mirënjohje

Anëtarët e Koalicionit dëshirojnë të falënderojnë të intervistuarit nga institucionet dhe organizatat e ndryshme për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë dhe të japin informacione dhe të dhëna të paçmueshme për këtë raport.

OJQ-ja udhëheqëse për publikimin e Raportit

ECMI Kosova (www.ecmikosovo.org)

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

**Rruga "Nëna Terezë" Nr. 20, Apt. 5,
10000 Prishtinë—Kosovë,
Tel. +383 (0) 38 224 473**

**Rruga "Kralja Petra" 183a
38220 Mitrovicë e Veriut—Kosovë,**

Koalicioni për të drejta të barabarta për të gjithë - ERAC

ERAC mbledh së bashku shtatë (7) OJQ që punojnë në fushën e sundimit të ligjit dhe të të drejtave themelore, të cilat punojnë së bashku me 19 OJQ, me fokus në ngritjen e një rrjeti të qëndrueshëm të OJQ-ve, që janë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ose të marginalizuara. Fokusi specifik i projektit janë këto grupe: komunitetet jo-shumicë, gratë, rinia, dhe komuniteti LGBT. Edhe pse punojnë apo shtrijnë veprimet e tyre në tema dhe çështje të ngjashme, këtyre OJQ-ve u mungon bashkëpunimi dhe shpesh përqendrimi i punës së tyre është i ndarë në bazë të grupeve të veçanta të synuara, me të cilat punojnë ato, apo i ndarë sipas rajoneve ku ato shtrijnë aktivitetet e tyre. Me krijimin e një bashkëpunimi strukturor në mes të OJQ-ve të përzgjedhura dhe me ofrimin e mundësive formale për mësim të vazhdueshëm, veprimi gjeneron shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes të OJQ-ve (duke përfshirë përvojën në çështjet institucionale), për të forcuar kapacitetet e tyre për avokim me institucionet qendrore dhe komunale, dhe për të rritur dukshmërinë e tyre në terren.

Anëtarë të ERAC-ut janë organizatat si më poshtë:

- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë –Organizatë lider e Koalicionit;
- Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore– anëtare e Koalicionit;
- Qendra për Barazi dhe Liri të komunitetit LGBT në Kosovë (CEL) – anëtare e Koalicionit;
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore - anëtare e Koalicionit;
- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - anëtare e Koalicionit;
- Kosovo 2.0 – anëtare e Koalicionit;
- Qendrën për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) - anëtare e Koalicionit;

Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ECMI Kosovo dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

E drejta e autorit©

Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC), tetor 2018. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të ERAC-ut.



NGRITJA E KAPACITETEVE GJUHËSORE TË NËNPUNËSVE CIVILË KOMUNALË



European
Union
Kosovo

PËRMBAJTJA

Hyrje	7
Barazia Gjuhësore në Nivelin Komunalë.....	8
Faktori Njeri: Aftësitë Gjuhësore të Nënpunësve Civilë.....	10
Praktika: Komunitat që përdorin vetëm një gjuhë.....	12
Mjetet Juridike.....	14
Rekomandimet	22
Literatura	26

SHKURTESAT

UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ZKGJ	Zyra e Komisionerit për Gjuhët
ZPGZ	Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare
ECMI Kosova	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve Kosovë
ERAC	Koalicioni të drejtat e barabarta për të gjithë

Të drejtat gjuhësore janë thelbësore dhe të rëndësishme për mbrojtjen efektive dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe për sigurimin e të drejtave të barabarta për të gjithë. Si element thelbësor i identitetit individual dhe kolektiv, gjuha zë një vend të rëndësishëm në Instrumentet Ndërkombëtare të të drejtave të Njeriut. Gjatë dy dekadave të fundit të drejtat gjuhësore janë theksuar më shumë edhe në instrumentet ndërkombëtare siç janë Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike (KNKBDP) dhe Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKEMPK).¹ Kryesore për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore është parimi i barazisë dhe parandalimi i diskriminimit në bazë të gjuhës.² Për komunitetet në veçanti, e drejta e lirisë së shprehjes përfshin të drejtën për të përdorur gjuhën e tij/saj në çështjet private dhe publike dhe për të marrë dhe për të dhënë informacion dhe ide në atë gjuhë.³

Kosova ka miratuar dispozita të gjëra për ruajtjen dhe promovimin e karakterit shumëgjuhësor të saj si shtet në përputhje me Marrëveshjet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, të cilat janë të aplikueshme në Kosovë, siç të cekura në Kushtetutën e Kosovës. Në Kosovë, gjuha Shqipe dhe Serbe janë dy (2) gjuhët zyrtare dhe kanë status të barabartë. Në nivelin komunal, gjuhët tjera mund të e marrin statusin në përdorim zyrtarë nëse 5% e popullit që jetojnë në atë komunë e flasin atë gjuhë. Gjuha Truke është e njohur si gjuhë zyrtare në komunën e Prizrenit në bazë të numrit të komunitetit që e flasin këtë gjuhë. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve thotë që gjuhët zyrtare në nivel komunal kanë status të barabartë dhe përdoren njëjtë në takime dhe punë në komunë. Çdo person në Kosovë ka të drejtë të komunikojë me autoritetet komunale dhe të marrë shërbime dhe të ketë çasje në dokumentet zyrtare në ndonjë prej gjuhëve zyrtare, dhe është përgjegjësi e çdo përfaqësuesi të komunës dhe trupit ekzekutiv të e sigurojë këtë mundësi.⁴

Në praktikë, megjithatë, ka shumë sfida në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Zbatimi në nivel jo të kënaqshëm i Ligjit është bërë disi çështje pragmatike e cila kontribon në krijimin e një zbrazëtire në mes të teorisë së një Kosove shumë-etnike dhe realitetit i cili tregon një rritje të ndarjes së

¹ Kushtetuta e Kosovës, Neni 22

² Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Neni. 2 (1)

³ Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Neni. 9.1 & 10.1; shih gjithashtu Deklaratën e OKB-së për të Drejtat e Personave që i përkasin Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, Neni. 2; dhe Dokumentin e Kopenhagës të OSBE-së Art. 32.1

⁴ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Nr. 02 / L-37], Neni. 7 (2)

shoqërisë. Organet ndërkombëtare vazhdimisht përsërisin dhe shtyjnë Kosovën të përmirësojë zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Raporti i fundit i Progresit i BE-së thekson që "përkushtim dhe mbështetje më e madhe duhet të ofrohet nga institucionet qeveritare në politikat kryesore" dhe se "zbatimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve mbetet në nivel jo të kënaqshëm".⁵ Ky raport fokusohet tek aftësitë e kushtëzuara gjuhësore të zyrtarëve komunal, fakt ky i cili krijon një boshllëk kryesorë në sigurimin e barazisë gjuhësore në nivelin komunal.

Ky raport mbështetet në: vlerësimet afatgjate të dala nga puna në teren e ECMI Kosovës e cila është e angazhuar për shumë vite në ofrimin e kurseve gjuhësore në gjuhën Shqipe dhe gjuhën Serbe për nënpunësit civilë komunalë; të gjeturat e mëparshme të studimeve të ndryshme të cilat janë bërë me qëllim të analizimit të nivelit të zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në nivelin lokal; dhe duke krahasuar dhe analizuar raste të cilat kanë të bëjnë me të drejtat gjuhësore në shtetet e Evropës. Duke u bazuar në analizën e thellë të legjislacionit të Kosovës dhe intervistave me përfaqësues të institucioneve kompetente siç është Zyra e Komisionerit për Gjuhët dhe Instituti Kosovar për Administratë Publike (IKAP), ky raport jep rekomandime të cilat do të shpien në një zgjidhje afatshkurtër apo afatmesëm për të adresuar nivelin e ulët të njohurive gjuhësore të nënpunësve civilë komunalë. Në këtë raport, ndër të tjera, sygjerohet që të bëhet institucionalizimi i kurseve të gjuhës Shqipe dhe Serbe për nënpunësve civilë, mënyrë kjo që do të sigurojë komunikim më efektiv dhe produktiv brenda në komunë, e edhe në mes të komunës dhe komuniteteve që jetojnë aty.

Barazia Gjuhësore në Nivelin Komunalë

Komunat janë ndoshta nivel i qeverisë që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët përmes ofrimit të shërbimeve publike, kontaktit të përditshëm, dhe në rastin specifik të Kosovës, që kanë përgjegjësi të mbrojnë të drejtat e komuniteteve dhe përfshirjen e tyre në jetën publike. Shërbimet që ofrohen në dy gjuhët zyrtare promovojnë përfshirjen, mbrojnë diversitetin dhe sigurojnë mosdiskriminim. Ato janë çelësi që vendos pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në jetën publike dhe forcimin e legjitimitetit të shtetit në nivel lokal. Mungesa e ofrimit të shërbimeve në gjuhën/gjuhët që mbajnë statusin në përdorim zyrtarë sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, pengon qytetarët të kërkojnë dhe marrin shërbimin e duhur dhe e zvogëlon mundësinë e pjesëmarrjes së tyre në jetën publike. Gjithashtu, zvogëlon legjitimitetin e shtetit të Kosovës dhe mund të i dëmtojë marrëdhëniet ndër-etnike. Vetëm atëherë

⁵ Komisioni Evropian, Raporti i Progresit Kosovë 2016, f.28 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf.

kur shteti, përmes komunave si përfaqësues më i madhë në përditshmërinë e njerëzve, arrin të ketë sukses në ofrimin e shërbimeve kualitative dhe cilësore në gjuhët zyrtare, mund të thotë që përfaqëson interesat e të gjithë qytetarëve dhe promovon dhe mbronë marrëdhëniet ndër-etnike në shoqëri. Duke e marrë parasysh historinë e konfliktit etnik në Kosovë, në të cilin gjuha shpesh ka shërbyer si pikë kryesore e ndarjes dhe ndryshimit, rëndësia e tejkalimit të kësaj sfide është edhe më e nevojshme dhe madhe.

Instrumentet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut cekin që autoritetet administrative duhet të merren me komunitetet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të barabartë, në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit.⁶ Pjesëmarrja efektive e komuniteteve kërkon përfaqësim të tyre dhe mundësi për të komunikuar në mënyrë efektive shqetësimet dhe nevojat e tyre specifike dhe për të marrë pjesë aktive në vendimmarrje.⁷ Për këtë arsye, autoritetet komunale duhet të u mundësojnë personave që u përkasin komuniteteve të marrin shërbimet në gjuhën/gjuhët e tyre. Me ngritjen e standardeve ndërkombëtare, gjithnjë e më shumë e shohim që masat positive janë të nevojshme që të sigurojnë "barazi të plotë dhe efektive për komunitetet kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës" dhe pjesëmarrje efektive në jetën politike dhe publike.⁸ Shtetet janë të detyruara të sigurojnë që institucionet (në nivel lokal dhe qendrorë) të përdorin gjuhët zyrtare të shtetit apo gjuhët e komuniteteve, dhe kërkojnë nga nënpunësve civilë "që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët" të përdorin gjuhën tyre "në rastet kur ata kërkojnë ndonjë shërbim të caktuar". Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale të Minoriteteve specifikon që masat duhet të ndërmirren për të lejuar dhe inkurajuar: aplikimet me gojë ose me shkrim, dhe të ipen përgjigjet në gjuhën përkatëse të komunitetit; të bëhet publikimi i dokumenteve zyrtare në gjuhët e komuniteteve; dhe të përdoret gjuha e komuniteteve në debatet e kuvendit komunal. Karta dhe Rekomandimet e Oslos thotë që realizimi i këtyre dispozitave mund të kërkojë nga komunat sigurimin e përkthimit ose interpretimit adekuat, si dhe të krijohen politika dhe programe të përshtatshme të rekrutimit dhe trajnimit.⁹ Legjislacioni i Kosovës i përshtatshëm në detaje këto rregulla. Qytetarët kanë të drejta të barabarta të i përdorin gjuhët zyrtare në kontaktet e tyre me institucionet në nivelin qendror

⁶ Rekomandimet e Oslos, Shënimi Shpjegues, paragrafi 15; Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Neni. 10 (2); Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale të Minoriteteve, Neni. 10; shih gjithashtu Dokumentin e OSBE-së në Kopenhagë, paragrafi 34.

⁷ Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Neni. 15; shih gjithashtu Deklaratën e OKB-së për të Drejtat e Personave që i përkasin Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, Neni. 2 (2) dhe Art. 2 (3), dhe Dokumentin e Kopenhagës të OSBE-së, paragrafi 35

⁸ Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Neni. 4 (2)

⁹ Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale të Minoriteteve, Neni. 10 (4) dhe Rekomandimet e OSBE-së në Oslo, paragrafi 14.

dhe lokal.¹⁰ Kështu që, qytetarët kanë të drejtë të komunikojnë me institucionet në nivel lokal dhe nënpunësit civilë, si dhe të marrin shërbime dhe të kenë qasje në dokumente publike në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare.¹¹ Të gjitha dokumentet publike dhe të dhënat, duke i përfshirë por duke mos i limituar, "minutat e takimeve, të dhënat zyrtare të përfaqësuesve komunal dhe trupes së ekzekutivit, regjistrat publik", duhet të jenë në dispozicion në të dy (2) gjuhët zyrtare.¹² Për më tepër, të gjitha rregulloret dhe aktet e miratuara nga institucionet komunale, duhet të printohen dhe publikohen në gjuhët zyrtare.¹³ Në punën dhe takimet e institucioneve komunale dhe trupave përfaqësues komunal, si dhe takimet e organizuara nga ta, të gjitha gjuhët që kanë statusin e gjuhës zyrtare duhet të përdoren në mënyrë të barabartë. Përkthimi i dokumenteve të punës dhe interpretimi në takime duhet të ofrohet sipas kërkesës.¹⁴ Institucionet komunale duhet të sigurojnë që ambientet e punës në çdo zyrë ofrojnë mundësi dhe liri që çdo gjuhë zyrtare të flitet lirshëm si dhe nënpunësve civilë të inkurajohen të përdorin secilën gjuhë zyrtare.¹⁵

Faktori Njeri: Aftësitë Gjuhësore të Nënpunësve Civilë

Shumë studime janë bërë ndër vite nga Qeveria, organizatat jo-qeveritare lokale dhe organizatat ndërkombëtare. Të gjitha këto kanë theksuar që ekziston një sërë problemesh dhe ngeçjesh në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Duke u fokusuar në nivelin lokal, këto studime kanë treguar vazhdimisht që njohuria e pamjaftueshme dhe përdorimi i gjuhëve zyrtare si dhe cilësia e dobët e përkthimit ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen efektive në çështjet komunale dhe qasjen në shërbime tek pjesëtarët e komuniteteve.¹⁶ Këto studime, megjithatë, kanë tendencë të përqëndrohen tek përkthyesit profesional, pasijet dhe mjetet, dhe legjislati. Ato shikojnë njohuritë gjuhësore të personave të cilët për momentin ofrojnë shërbime publike në komuna në gjuhë të ndryshme në të shkruar dhe folur. Në mënyrë që të jenë të gatshëm të ofrojnë shërbime

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës Art. 59 (6); Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Nr. 02 / L-37], Neni. 2.2.

¹¹ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Nr. 02 / L-37], Neni. 7.2.

¹² Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Nr. 02 / L-37], Neni. 7.4.

¹³ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Nr. 02 / L-37], Neni. 7.6.

¹⁴ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Nr. 02 / L-37], Neni. 7.3 and Art. 8.3, Shih gjithashtu Udhëzimin Administrativ për Përcaktimin e Procedurave për Zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve [MAPL UA Nr. 2007/06], Pjesa e Katërt, Neni 7, Neni. 7.1.

¹⁵ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Nr. 02 / L-37], Neni. 7.5

¹⁶ Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) / Zyra e Kryeministrit (2015). Monitorimi dhe Vlerësimi i të Drejtave të Gjuhëve në Kosovë. Në dispozicion në internet http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/Anglisht_Finale_160315.pdf

OSBE (2012). Legjislati shumëgjuhësh në Kosovë dhe sfidat e tij <https://www.osce.org/kosovo/87704?download=true>

OSBE (2015). Pajtuueshmëria e Gjuhëve Komunale në Kosovë <https://www.osce.org/kosovo/120010?download=true>

cilësore qytetarëve në gjuhë të ndryshme, nëpunësit civilë komunalë duhet të zotërojnë në nivel profesional të gjitha gjuhët zyrtare që janë në komunë. Kjo veçanërisht vlen për ata nëpunës të cilët janë në kontakt direkt me qytetarët. Duke u bazuar në Ligj, nëpunësve civilë duhet të jenë të gatshëm të ofrojnë informata me shkrim dhe me gojë të gjithë qytetarëve në të gjitha gjuhët zyrtare, e në gjuhën Shqipe dhe Serbe sipas përkufizimit.¹⁷ Nëpunësit civilë promovojnë shtetin dhe karakterin shumë-gjuhësorë të tij. Nëse nëpunësit civilë nuk kanë aftësi për të komunikuar në gjuhën e tyre dhe nuk kanë nivel të kënaqshëm të njohjes së gjuhës tjetër zyrtare, pjesëtarët e komuniteteve do të dekurajohen dhe nuk do të kenë vullnet të konsultohen me komunën dhe do të tërhiqen nga sfera publike.

Mirëpo, nevoja për kapacitete gjuhësore shkon përtej nëpunësve civilë të cilët janë në kontakt direkt me qytetarët. Dygjuhësia në ambientin profesional është gjithashtu çelësi i integritit të punëtorëve të komuniteteve të ndryshme në institucionet lokale në komunat e përziera etnikisht. Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejta kushtetuese të jetë të përfaqësuar në mënyrë të denjë në institucionet publike dhe zotërojnë ndërmarrje në të gjitha nivelet.¹⁸ Neni 101 (1) i Kushtetutës për më tepër, shpjegon që përbërja e shërbimit publik "do të reflektojë diversitetin e popullit të Kosovës". Në nivel lokal, ekzistojnë vendet e rezervuara të cilat pasqyrojnë përqindjen e komuniteteve në komunë, vende të cilat duhet të rezervohen për pjesëtarët e kualifikuar të komunitetit.¹⁹ Zyrtarët komunalë kanë të drejtë të përdorin secilën prej gjuhëve zyrtare në punën e tyre dhe institucionet komunale duhet të sigurojnë që mjediset e punës të jenë inkurajuese për përdorim efektiv të çdo gjuhe zyrtare nga zyrtarët dhe punonjësit e tyre.²⁰ Çdo institucioni i kërkohet që në mënyrë aktive të ndërmarrë masa pozitive për të promovuar përdorimin e dy (2) gjuhëve zyrtare nga të gjithë të punësuarit dhe të raportojë për numrin e punonjësve që janë në gjendje ose dëshirojnë të komunikojnë në dy (2) gjuhët zyrtare të Kosovës.

Pavarësisht nga dispozitat ligjore që sigurojnë përfaqësim të barabartë të komuniteteve, niveli deri ku një pjesëtar i ndonjë komuniteti është në gjendje të marrë pjesë në mënyrë efektive në punët komunale varet shpesh nga niveli i njohurive të gjuhëve zyrtare. Mundësitë për të mësuar gjuhët zyrtare dhe shumëgjuhësinë institucionale mungojnë, rrjedhimisht, njohja e ulët e një gjuhe zyrtare mund të paraqesë pengesë të konsiderueshme për punësim, pjesëmarrje efektive dhe qasje në shërbime. Njohja e dobët e gjuhëve zyrtare nga anëtarët

¹⁷ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Nr. 02/L-37], Neni 7.2.

¹⁸ Kushtetuta e Kosovës, Neni 61

¹⁹ Ligji për Shërbimin Civil të Kosovës [Ligji Nr.03/L – 149], Neni 11(3)

²⁰ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Nr. 02/L-37], Neni 7.5

e komuniteteve është theksuar si një nga pengesat kryesore për arritjen e përfaqësimit të barabartë të tyre në institucionet publike.²¹ Përveç kësaj, nivelet e ulëta të dygjuhësisë të stafit komunal rrisin kërkesën për të marrë shërbime nga përkthyesit e angazhuar ose varen nga mbështetja e nënpunësve civilë komunal me njohuri gjuhësore nga komunat tjera.²²

Praktika: Komunat që përdorin vetëm një gjuhë

Duke marrë parasysh ato që u thanë më lartë, është veçanërisht shqetësuese që aftësitë gjuhësore të nënpunësve civilë komunalë janë në përgjithësi të dobëta dhe se aftësitë e tilla po zvogëlohen me moshë. Hulumtimi i ECMI Kosovës në vitin 2010 i cili është zhvilluar me nënpunësit civilë komunalë në pesë (5) komuna konstatoi se njohja e gjuhës Shqipe nga komunitetet që flasin gjuhët tjera është shumë e ulët, veçanërisht nga komuniteti Serb, ku shumica prej tyre nuk e flasin gjuhën Shqipe aspak. Shumica e qytetarëve që e kanë gjuhën Shqipe gjuhë të parë, vlerësojnë që njohuritë e tyre të gjuhës Serbe janë në nivel mesatarë, që do të thotë se komunikimi në gjuhën Serbe është i mundshëm, por përdorimi kësaj gjuhe në kontekst profesional është i kufizuar, gjë që krijon një ngecje të konsiderueshme në komunikimin midis zyrtarëve që flasin gjuhë të ndryshme. Është vërejtur që të gjitha komunat kanë një numër të konsiderueshëm të zyrave që përdorin gjuhën Shqipe si gjuhë të vetme të punës, fakt ky që mund të anashkalojë në mënyrë të konsiderueshme folësit të gjuhëve tjera. Për më tepër, njohja e gjuhës Shqipe dhe Serbe nga pjesëtarët e komunitetit Serb dhe Shqiptarë, respektivisht, po bie me moshë. Sa më i ri/ e re të jetë nënpunësi civilë komunalë, aq më e varfër është njohuria e gjuhës së dytë zyrtare.²³ Një hulumtim i kryer nën monitorimin e Zyrës së Komisionerit për Gjuhët në vitin 2015 konstatoi se, sa i përket përfaqësimit gjuhësor (gjuhës amtare) të nënpunësve civilë komunalë, ekziston një trend i rritjes së njëgjuhësisë.²⁴

Rritja e tredit të njëgjuhësisë reflekton në mungesën e pajtueshmërisë së gjuhës për dokumentet zyrtare, faqet e internetit të komunave dhe shenjave, si dhe postimet komunale për mundësi punësimi. Në shumë komuna, dokumentet zyrtare janë përkthyer në mënyrë të parregullt dhe cilësia e përkthimit shpesh

²¹ Zyra për Çështje të Komuniteteve / ECMI Kosovë, Studimi i Politikave I: Punësimi i Pjesëtarëve të Komuniteteve Jo-Shumicë në kuadër të Shërbimit Civil të Kosovës dhe Ndërmarrjeve Publike, f.103

²² Për shembull, nga 63 zyrtarë komunalë të intervistuar nga ECMI, 42 treguan se konsultohen me një koleg nëse nuk kanë njohuri për gjuhën, ndërsa 15 përmendin përdorimin e tyre të përkthyesve / përkthyesve komunalë (përgjigje të shumëfishta ishin të mundshme).

²³ Raporti i ECMI mbi kompetencat gjuhësore të zyrtarëve komunal, 2010, f. 38.

²⁴ Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) / Zyra e Kryeministrit (2015). Monitorimi dhe Vlerësimi i të Dhënave të Gjuhëve në Kosovë, f. 25-26. Në dispozicion në internet http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/Englisht_Final_160315.pdf

është e dobët, megjithëse ligji kërkon që të gjitha dokumentet zyrtare të përkthehen në të dyja gjuhët. Në kundërshtim me ligjin, takimet komunale shpesh mbahen në një gjuhë ekskluzivisht, pa përkthim, gjë që pengon pjesëmarrjen e folësve të gjuhëve tjera, veçanërisht duke marrë parasysh që njohuritë e gjuhës së dytë zyrtare janë në nivel të ulët. Në këto raste, komunat duhet të mbështeten në shërbime të përkthimit (të ofruar nga komuna vet apo të kontraktuara), që kanë çmim të lartë dhe është vështirë të gjinden pasi që ka mungesë të përkthyesve të specializuar në Kosovë.²⁵

Në mungesë të mundësive institucionale për pjesëmarrje në trajnime të cilat kanë për qëllim ngritjen e njohurive gjuhësore të nënpunësve civilë, ECMI Kosova në vitin 2011 ka prezantuar një pilot projekt i cili kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve gjuhësore të nënpunësve civilë, projekt i cili ishte i financuar nga OSBE Komisioneri i Lartë për Pakica Kombëtare dhe Zyra e Komisionerit për Gjuhët, Zyra e Kryeministrit. Në vitin 2011, organizimi I kurseve të gjuhës Shqipe dhe Serbe është bërë vetëm në një komunë, dhe pas rezultateve të mira të arritura, programi u zgjerua edhe në komunat tjera. Në vitin 2012, programi ka përfshirë tri (3) komuna. Në vitin 2013, është zgjeruar në dhjetë (10) komuna dhe është shtriturë në të gjitha rajonet e Kosovës me gjithsejt 295 pjesëmarrës. Në vitin 2014, ECMI Kosova ka marrë një hap i cili e ka zgjeruar programin dhe ka përfshirë edhe katër (4) komunat të cilat janë të banueshme vetëm me komunitetin Serb, dhe që gjinden në Jug të lumit Ibër si dhe Zyrën Administrative në Veri të Kosovës. Në vitin 2015, ka qenë prezente në trembëdhjetë (13) komuna, duke përfshirë gjithsejt 286 pjesëmarrës. Në vitin 2016 u përfshin dymbëdhjetë (12) komuna me 362 pjesëmarrës. Në vitin 2017, për shkak të zgjedhjeve lokale në vend dhe zvogëlimit të fondeve, ishte e pamundur për ECMI Kosovën të arrijë një marrëveshje me disa komuna të targetura; megjithatë, kurse dymujore u organizuan në shtatë (7) komuna.

Në ofrimin e kurseve në gjuhën Serbe është përdorur kurrikula bazike dhe e avancuar kurse në ofrimin e kurseve në gjuhën Shqipe është përdorur kurrikula bazike. Materialet e trajnimit janë marrë nga disa libra të cilët janë të dizajnuar për mësimin e gjuhës Shqipe dhe Serbe si gjuhë të dytë. Kurset janë mbajtur gjatë orarit të punës, në mënyrë që pjesëmarrja të jetë më atraktive, edhe pse ka pasur disa probleme me disa zyrtarë të cilët në punën e tyre janë në kontakt

²⁵ Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) / Zyra e Kryeministrit (2015). Monitorimi dhe Vlerësimi i të Drejtave të Gjuhëve në Kosovë. Në dispozicion në internet http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/Englisht_Finale_160315.pdf

OSBE (2012). Legjislacioni shumëgjuhësh në Kosovë dhe sfidat e saj <https://www.osce.org/kosovo/87704?download=true>

OSBE (2015). Pajtueshmëria e Gjuhëve Komunalenë Kosovë. <https://www.osce.org/kosovo/120010?download=true>

të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe të cilët nuk kanë mundur të marrin pjesë në kurse për arsye që mungesa e tyre ka pasur ndikim negative në ofrimin e shërbimit të qytetarëve. Testimi është organizuar si metodë e vlerësimit të arritjeve të pjesëmarrësve përgjatë ndjekjes së kurseve. Pjesëmarrësit kanë marrë certifikata të pjesëmarrjes pas përfundimit të kursit, nëse kanë marrë pjesë rregullisht dhe kanë qenë të dedikur në nritjen e kapaciteteve të tyre gjuhësore.

Kurset e ECMI Kosovës kanë treguar sukses të madhë, dhe marrë komente pozitive. Për të e mbështetur këtë, duhet të theksohet që në vitin 2016 kënaqësia e pjesëmarrësve ishte 4.19 dhe 4.48 nga 5 për kurset e gjuhës Shqipe dhe Serbe, respektivisht; në vitin 2017 kënaqësia e pjesëmarrësve ishte më e madhe me 4.33 dhe 4.55 për kurset e gjuhës Shqipe dhe Serbe, respektivisht. Pjesëmarrja e zyrtarëve në kurse ishte e lart, 75% e tyre kanë qenë të rregullt në vitin 2016 dhe 59% kanë qenë të rregullt në vitin 2017. Disa përvoja të dala nga analizimi i pjesëmarrjes në kurse, megjithatë, duhen të cekën: shpesh, ka pasur numër më të vogël të pjesëmarrësve në kurse për shkak se lista e propozuar nga komuna nuk ishte e përditësuar nga viti në vit kështu që disa persona që ishin në lista nuk kishin mundësi të marrin pjesë në këto kurse; një çështje e veçantë ishte se shumë pjesëmarrës shpesh kishin angazhime tjera gjatë kohës së mbajtjes së kurseve; një ndikim tjetër i zvogëlimit të numrit të pjesëmarrësve ishte që kurset ishin të dedikuara për ata zyrtarë të cilët punë të përditshmërisë së tyre e kanë kontaktin e drejtpërdrejtë me qytetarët, dhe të cilët ndonjëherë ishin të detyruar të e lëshojnë orën për shkak të detyrës së tyre. Në përgjithësi, kurset kanë sjellë përparim të dukshëm tek ata që kanë qenë pjesëmarrës aktiv dhe e kanë përfunduar kursin, dhe mund të thuhet që niveli i komunikimit të tyre në gjuhën e tyre të dytë është përmirësuar.

Mjetet Juridike

Sigurisht që Kosova nuk është vendi i vetëm shumë-gjuhësor në botë. Në shumicën e vendeve shumëgjuhëshe, në rastet e hapura për aplikim për punë në administratën qendrore shumëgjuhësia apo dygjuhësia është kusht. Kushtetuta e Kanadasë thekson që gjuha Angleze dhe Frënge janë gjuhë zyrtare, dhe kanë status të barabartë. Në rreth 40% të pozitave në Qeveri duhet të jenë të punësuar folës të të dy gjuhëve, dhe si shpërblim për këtë kualitet, Qeveria u jep punonjësve një bonus prej 800 dollarësh Kanadez çdo vit.²⁶ Në Zvicërr, shërbimet ndaj qytetarëve ofrohen në të gjitha gjuhët zyrtare të cilat janë: Gjermane, Frënge dhe Italiane. Për më tepër, neni 20 i Ligjit Federal për Gjuhët dhe Mirëkuptimin

²⁶ <http://www.officiallanguages.gc.ca/en/timeline-event/bilingualism-bonus-federal-public-servants-introduced>

midis Komuniteteve Gjuhësore thotë: "Konfederata do të inkurajojë punonjësit e saj për të zgjeruar njohuritë e tyre për gjuhët kombëtare".²⁷ Në Belgjikë, më në fund, njohja e gjuhës Holandeze, Franceze, dhe Gjermane është kërkesë për nënpunësit civilë. Ata janë të obliguar të komunikojnë me qytetarët dhe institucionet tjera qeveritare në gjuhën e tyre të rajonit.

Në nivelin lokal qeverisës, shërbimet e ofruara në më shumë se një gjuhë përcaktohen sipas nevojë së vendit dhe se cila është gjuha që përdoret aty. Në Kanadë, çdo provincë dhe territor i Kanadës, mund të vendos rregulla në lidhje me përdorimin e gjuhëve. Provinca e Brunswik-ut të Ri është e vetmja provincë në Kanadë në të cilën përdoren dy gjuhë. Gjuha Frënge dhe Anlgeze janë gjuhët zyrtare dhe kërkohet përdorim i barabartë i tyre në ofrim të shërbimeve ndaj qytetarëve sikurse është e rregulluar në Aktin Zyrtarë të Gjuhëve të Brunswick-UT Të Ri.²⁸ Rajonet e Zvicrrës kanë autoritet të vendosin gjuhën e tyre e cila do të jetë në përdorim zyrtarë, ku si rrjedhojë në shumicën e vendeve përdoret veç një gjuhë; kështu që, një person që e flet gjuhën Italiane dhe që kërkon shërbime në një rajon ku gjuha zyrtarë është gjuha Gjermane, ai/ajo nuk do të mund të shërbehet në gjuhën e tij/saj.²⁹ Shërbimet vetëm në një gjuhë në nivel rajonal nuk shihen si problematike në Zvicërr sepse ndarja e territorit në nivel gjuhësorë është bërë me kujdes në të gjithë shtetin. Në Belgjikë, komunat kanë veç një gjuhë zyrtare. Megjithatë, në kryeqytetin shumëgjuhësorë të Brukselit shërbimet publike ofrohen në më shumë se një gjuhë. Një numër i komunave në të cilat përdoren shumë gjuhë ofrojnë shërbime në këto gjuhë: Holandeze, Gjermane dhe Frënge. Për më tepër, përveç gjuhëve të tyre zyrtare, folësit e gjuhës jo-dominante kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre në komunikimin e tyre me institucionet publike.³⁰ Finlanda, është shtet dygjuhësorë ku gjuhë zyrtare janë gjuha Finlandishte dhe Suedeze. Qeveria e këtij shteti siguron që përdorimin i të dyja gjuhëve reflekton në të gjitha institucionet qeveritare. Nënpunësve shtetërorë u kërkohet me status të kenë diplomë akademike në institucionet dygjuhësore, me qëllim që ata të kenë aftësi të nivelit të shkëlqyeshëm të flasin dhe shkruajnë në gjuhën e përdorur nga shumica në atë rajon, dhe të kenë aftësi të kënaqshme të flasin dhe shkruajnë në gjuhën tjetër zyrtare. Kërkesa në një vend njëgjuhësorë, është që nënpunësit të kenë aftësi të shkëlqyera për të folur dhe shkruar gjuhën zyrtare dhe aftësi të kënaqshme për të kuptuar gjuhën tjetër.³¹ Këto aftësi analizohen nga testet gjuhësore të administratës shtetërore në Finlandisht dhe Suedisht, të organizuar dhe drejtuar nga Bordi Kombëtar

²⁷ <https://www.admin.ch/opc/en/classified-compilation/20062545/201701010000/441.1.pdf>

²⁸ <http://officiallanguages.nb.ca/faq>

²⁹ <https://www.uottawa.ca/clmc/internationalperspective/switzerland>

³⁰ <https://portal.cor.europa.eu/divisionpowers/countries/membersLP/Belgium/Pages/default.aspx>

³¹ Ministria e Drejtësisë së Finlandës, Akti për njohjen e gjuhëve të kërkuara të personelit në organet publike nr. 424/2003, Neni 6 (1)

për Arsim.³² Kështu që, autoritetet komunale duhet të sigurojnë që nëpunësit e administratës së tyre të kenë aftësi të mjaftueshme gjuhësore dhe duhet të i ngrisin kapacitetet gjuhësore të tyre duke organizuar kurse ose duke ndërmarrë masa tjera politike kur është e nevojshme, me qëllim të përmbushjes së detyrave të tyre.³³ Së fundmi, Qeveria ka nisur gjithashtu me një program trajnimi mbi të drejtat gjuhësore për zyrtarët qeveritarë dhe nëpunësit civilë, i cili ka filluar të zbatohet në vitin 2017 dhe do të zgjasë deri në vitin 2020.³⁴

Parakusht themelor për ofrimin e shërbimeve publike shumëgjuhëshe në shtetet shumëgjuhëshe është sistem arsimor i cili i mëson fëmijët gjuhët e tjera zyrtare që në moshë të hershme. Në Kosovë, megjithatë, sistemi arsimor është aktualisht i ndarë në kurrikulë në gjuhën Serbe dhe në gjuhën Shqipe, kështu që nuk ofron arsimim të gjuhës së dytë. Në fakt, njohja relativisht e mirë e gjuhës Serbe nga shqip folësit në zyrat komunale daton nga mësimi i detyrueshëm i gjuhës Serbe si gjuhë e dytë në Jugosllavinë Socialiste (në të kundërtën, gjuha Shqipe u mësua rrallë në mënyrë sistematike fëmijëve Serbisht folës). Megjithatë, që nga vitet 1990, kjo praktikë është shfuqizuar, dhe si rrjedhojë kemi rënie të njohjes së gjuhës Shqipe dhe Serbe nga gjeneratat e reja. Ky fakt shpjen në mungesën e mundësisë së ngritjes së problemit të komunave që përdorin veç një gjuhë në Kosovë në periudhë më afatgjate. Duke e cekur edhe një herë shembullin pozitiv të Finlandës, mund të themi që vërehet që ky shtet është shtytës i madhë i arsimimit në gjuhën Suedeze si gjuhë të dytë, që do të thotë që mbi 98% të studentave në klasën 7 - 9 mësojnë gjuhë tjetër alternative përveç gjuhës kryesore në të cilët ata arsimohen.³⁵ Rrjedhimisht, efektet e kësaj, shihen në aftësinë e nëpunësve civilë të Finlandës dhe qytetarëve të saj që i flasin dy gjuhë.

Duke pasur parasysh nevojën për përmirësim të arsimit në gjuhën e dytë në Kosovë, ECMI Kosova ka ndërmarrë një iniciativë për të përmirësuar dhe zvogëluar këtë problem në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja "Mbështetje për arsimin në gjuhën serbe në Kosovë". Ky projekt synon të përmirësojë cilësinë e arsimit të gjuhës serbe në mbarë Kosovën dhe të rrisë përfaqësimin e komuniteteve në institucionet e Kosovës. Disa nga objektivat e projektit janë: hartimi dhe vlerësimi i statusit të arsimit në gjuhën serbe në Kosovë; mbështetja e dhënë MASHT-it

³² Ibid. Nenet 10-11

³³ Ibid. Neni 2

³⁴ Ministria finlandeze e Drejtësisë, Plani i Veprimit për Strategjinë për Gjuhët Kombëtare të Finlandës, 28 shkurt 2017, https://oikeusministerio.fi/documents/1410853/4734397/ActionPlan_StrategyfortheNationalLanguages.pdf/5513fe14-d092-4404-9ec1-d3a6e6a354af/ActionPlan_StrategyfortheNationalLanguages.pdf.pdf

³⁵ <http://www.efnil.org/documents/conference-publications/london-2011/the-role-of-language-education-in-creating-a/15-Pirkko-Nuolijarvi.pdf>

në krijimin e udhërrëfyesit për zhvillimin ligjor dhe institucional të gjuhës Serbe; dhe verifikimi i diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës Veriore për të lejuar të diplomuarit të mund të punësohen në institucionet publike të Kosovës. Ngjajshëm, ECMI Kosova ka qenë gjithashtu pjesë e vendimit të fundit dhe jashtëzakonisht të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës për të krijuar një grup punues në lidhje me arsimin në gjuhën Serbe në vend. Sipas nenit 4 të këtij vendimi, ky grup punues do të prodhojë "një analizë të përgjithshme të gjendjes aktuale të arsimit të gjuhës Serbe në Kosovë, e cila do të shërbejë si një dokument për strategjinë afatgjatë të Kosovës për përfshirjen e arsimit të gjuhës Serbe në kuadrin institucional të Kosovës".³⁶ Ky vendim është një zhvillim i rëndësishëm në normalizimin e arsimit në gjuhën Shqipe dhe Serbe në Kosovë, dhe në një periudhë më afatgjatë shpresojmë që të inkurajojë një rritje të njohjes të të dy gjuhëve tek ata që janë të arsimuar në të dy sektorët.

Një hap tjetër pozitiv në këtë kontekst është fillimi i një projekti i cili ka të bëjë me çështjet gjuhësore nga Këshilli i Evropës në kuadër të sistemit arsimor të Kosovës. Ky projekt, i cili po zbatohet nga maji 2018 dhe do të jetë deri në prill 2020, synon të "promovojnë një imazh pozitiv shumëgjuhësorë dhe shumëkulturorë në nivel lokal dhe rajonal si pasuri sociale, kulturore dhe ekonomike, qasje në nxënien e gjuhës dhe arsim për qytetari demokrate, ku të gjitha këto kontribuojnë në përmirësimin e raporteve ndërmjet komuniteteve".³⁷ Ky qëllim do të arrihet përmes disa rezultateve siç janë: studime të publikuara të cilat analizojnë qëndrimet gjuhësore dhe kulturore të të rinjve; aktivitete të ndryshme të ngritjes së kapaciteteve të organizuara me ekipet e shkollave dhe një sërë projektesh në shkolla me qëllim të ngritjes së vetëdijës për rëndësinë e njohjes së një gjuhe; dhe një studim i cili do të bëjë vlerësimin, dhe i cili do të nxjerrë një sërë rekomandimesh të cilat do të jenë të bazuara në gjetje. Këshilli i Evropës do të punojë me rreth dhjetë (10) shkolla në të gjithë Kosovën në këtë projekt dhe gjithashtu do të përpiqet të krijojë lidhje në mes të shkollave të Kosovës dhe shkollave të shteteve të Evropës, me qëllim që në të ardhmen të organizohen vizita studimore dhe të ketë programe të shkëmbimit të studentëve.

Gjithashtu, duhet cekur që në lidhje me këtë, një numër aktiviteteve tjera të organizuara nga Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) dhe akterë tjerë të cilët punojnë në promovimin e gjuhës dhe ngritjes së vetëdijës tek fëmijët. Në veçanti, ZKGJ është momentalisht duke u përpjekur për të i vënë rëndësi mësimin të të dy gjuhëve zyrtare me anë të përdorimit të disa medimeve siç janë: burimet online; aplikacionet e telefonit; dhe përmes klasave gjuhësore në televizionin shtetëror

³⁶ Vendimi i Zyrës së Kryeministrit Nr 251/2018, 16 gusht 2018, Neni. 4

³⁷ Këshilli i Evropës, Nxitja e Përpunueshmërisë përmes Edukimit për Demokraci dhe Mësim Gjuhësor, <https://rm.coe.int/fostering-rapprochement-through-education-for-democracy-and-language-/16808e8be1>

RTK.³⁸ Kjo është vënë në dukje në arritjen e nivelit A1 nga pjesëmarrësit. Ka gjithashtu plane për të vazhduar me organizim të nivelit A2. Për më tepër, ZKGJ gjithashtu koordinon dhe organizon ngjarje dhe aktivitete të cilat kanë për qëllim ndërgjegjësimin qytetarëve për rëndësinë e gjuhës, veçanërisht duke u fokusuar tek fëmijët që e ndjekin shkollën.³⁹

Pavarësisht nga aktivitetet e organizuara nga KE dhe ZKGJ, nevoja për përdorim të të dy gjuhëve nga nënpunësit civilë në Kosovë kërkon veprime të mëtejshme. Prezantimi idesë së organizimit të mësimi të gjuhës Shqipe në shkollat ku mësohet në gjuhën Serbe, është veprim shumë i ndjeshëm i cili mund të ketë ndikim politik, dhe i cili pikërisht për këtë ndjeshmëri, ka mbetur pa u trajtuar tash e sa vite. Edhe nëse gjuha Shqipe do të futet në kurrikulë në arsimin fillor dhe dytësorë, prapë do të ekzistojë zbrazëti e dy dekadave të gjeneratave, deri sa ata që do të e mësojnë gjuhën tjetër të jenë të gatshëm të mund të bëhen pjesë e Shërbimit Civilë. Përderisa fokusimi në arsim mendohet të ketë një zgjidhje afatgjate në ngritjen e kapaciteteve gjuhësore në Institucionet e Kosovës, fokusi vetëm në këtë formë, do të krijojë një “boshllëk gjeneratash” ku së paku një gjeneratë, nëse jo më shumë, e nënpunësve civilë do të e flasë vetëm një gjuhë. Ky fakt do të pengojë komunikimin brenda zyrave komunale; për më tepër, do të kufizojë mundësinë e zyrtarëve komunal për të bashkëpunuar me komunitetet rreth tyre. Prandaj, është e domosdoshme që IKAP-i dhe institucionet e tjera relevante të Kosovës të fokusohen gjithashtu në nxitjen e mësimi të gjuhës së dytë nga nënpunësit civil që janë pjesë e institucioneve qeveritare të Kosovës në afat të shkurtër.

Veprimet afatshkurtëra sigurisht që janë të mundshme, të cilat do të mund të ngrisin vetëdijen e nënpunësve civilë komunalë që është e nevojshme që ata të ofrojnë shërbime në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës.⁴⁰ Sipas Ligjit për Komunitete, Kosova duhet të zhvillojë programe të punësimit në institucione publike dhe të marrë masa tjera për të ndihmuar pjesëtarët e komuniteteve dhe të i mbrojnë ata nga çdo formë e diskriminimit dhe të arrijnë standardet e kërkuara për të u pranuar në pozitë të hapura në shërbimet publike.⁴¹ Ofrimi i trajnimeve për ngritjen e njohjes së gjuhës së dytë, të cilat janë të dedikuara për nënpunësit civilë parashikohen në Rregulloren lidhur me mandatin e Zyrës së Komisionerit për Gjuhët.⁴² Megjithatë, mundësitë e nënpunësve civilë komunalë për të mësuar të gjitha gjuhët zyrtare mbeten shumë të kufizuara. As

³⁸ Intervistë me Komisionerit për Gjuhë, Slaviša Mladenović, tetor 2018.

³⁹ Ibid.

⁴⁰ Raporti I ECMI Kosovës në Kompetencat Gjuhësore të Zyrtarëve Komunal, 2010, f. 38.

⁴¹ Ligji për Komunitete, Neni. 9(2) dhe 9(6)

⁴² Rregullorja 07/2012 e Zyrës së Komisionert për Gjuhët, Neni. 20 (3.3)

institucionet në nivel qendrorë e as ndonjë nga komunat nuk ofrojnë mundësi të ofrimit të kurseve të gjuhëve zyrtare për nënpunësit civilë komunalë.⁴³ IKAP-i, si institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit dhe edukimit dhe ngritjes së kapaciteteve në nënpunësve civilë,⁴⁴ nuk ka ofruar asnjë trajnim për rritjen e kapaciteteve gjuhësore të zyrtarëve komunalë që nga viti 2011-2012.⁴⁵ Strategjia për Trajnime të Nënpunësve Civilë në Kosovë 2016 – 2020, e publikuar nga IKAP, megjithatë, nuk tregon ndonjë hap drejt avancimit të përdorimit të gjuhëve zyrtare nga nënpunësit civilë komunalë.⁴⁶ Duhet të përmendet që IKAP-i aktualisht po përpiqet të “përmbushë” kërkesat gjuhësore, për shembull, duke theksuar rëndësinë e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, gjatë trajnimeve ditore të stafit.⁴⁷ Megjithtë, qëllimi kryesorë i IKAP-it për zbatimin e Strategjisë së Trajnimit bien nën pesë (5) objektiva kryesore: ngritjen e kapaciteteve duke u fokusuar në trajnime për integritetin profesional; anëtarësimin në Bashkimin Evropian; shërbimet administrative; teknologjia e informacionit; dhe centralizimi i financave. Misioni i IKAP-it dhe organizimi i trajnimeve për nënpunësit civilë është forcimi i sundimit të ligjit, demokracia dhe integriteti Evropian. Trajnimet që kanë të bëjnë me çështjet gjuhësore janë pjesë e rëndësishme e të gjitha fushave të lartpërmendura: është një objektivi në vetvete, si dhe një ndihmë në realizimin e qëllimeve të tjera, si përmirësimi i shërbimeve administrative dhe rruga drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. IKAP-i, për momentin nuk ka kapacitet të ofrojë trajnime duke u fokusuar në çështjet gjuhësore për nënpunësit civilë komunal: kjo për faktin që ka mungesë të mjeteve financiare dhe njerëzore. Duhet të ceket se që nga viti 2011 – 2012, IKAP-i nuk ka ofruar ndonjë program të trajnimit për nënpunësit civilë komunalë për ngritjet e kapaciteteve të tyre gjuhësore.⁴⁸ Roli i IKAP-it është ekzekutiv: instituti i mungon kapaciteti i krijimit të politikave dhe është i varur nga Ministria e Administratës Publike për vendimet strategjike dhe alokimin e buxhetit. Për të institucionalizuar programet trajnimit apo ofrimin e kurseve në gjuhën Shqipe dhe Serbe duhet të merret një vendim i cili do të ketë edhe ndikim politik, dhe i cili mund të merret vetëm nëse ekziston vullneti politik i Ministrisë së Administratës Publike. Gjithashtu kërkohet edhe mbështetje e jashtme nga ECMI Kosova dhe ndoshta nga akterë tjerë relevantë.

⁴³ Zyra për Çështje të Komuniteteve/ECMI Kosova, Studim I: Punësimi i Pjesëtarëve të Komuniteteve Jo-shumicë në kuadër të Shërbimit Civil të Kosovës dhe Ndërmarrjeve Publike, f. 92

⁴⁴ Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës [Ligji Nr. 03 / L-149], Neni. 10

⁴⁵ Intervistë me z. Enver Haxhijaj, Drejtor i Programit të Trajnimeve në IKAP, nëntor 2018

⁴⁶ Plani i veprimit për periudhën trevjeçare 2016-2018 për zbatimin e strategjisë për trajnimin e nënpunësve civilë 2016-2020 <https://map.rks-gov.net/getattachment/649247f0-f60a-4fd0-aae6-30ab39c933ac/.aspx>.

⁴⁷ Intervistë me Komisionerit oer Gjuhët, Z. Slaviša Mladenović

⁴⁸ Intervistë me z. Enver Haxhijaj, Drejtor i Programit të Trajnimeve në IKAP, nëntor 2018

Duke pasur parasysh çka u tha më lartë, nevoja për trajnim apo kurse të institucionalizuara të gjuhës duhet të konsiderohet nga Ministria e Administratës Publike si prioritet më i madh. Pa dyshim, ka vështirësi në gjetjen e mjeteve financiare; megjithatë, duke pasur parasysh efektet pozitive të organizimit të programeve, ndarja e mjeteve është e arsyetueshme pa dyshim. Aktivitetet e ECMI Kosovës në ofrimin e trajnimeve të tillë kanë shënuar progres dhe rezultate të konsiderueshme; dhe kjo punë duhet të vazhdohet nga vetë IKAP-i. ECMI Kosova është e gatshme të bashkëpunojë dhe të jap mbështetje duke u bazuar në përvojën e saj në organizimin e trajnimeve/kurseve për ngritje të kapaciteteve gjuhësore. Koordinimi me qëllim të institucionalizimit të programeve të tilla të trajnimit konsiderohet të ketë disa përfitime strukturore. Së pari, mësimi i gjuhës/gjuhëve do të ketë më shumë legjitimitet pasi që është përgjegjësi dhe prioritet i qeverisë në nivel qendrorë, dhe jo e një akteri të jashtëm siç është ECMI Kosova. Njëjtë, do të mundësohet monitorimi më i lehtë i organizimit të programeve të trajnimit apo kurseve, pasi që përgjegjësia për të e bërë këtë do të i kalojë strukturave të brendshme komunale, e jo ECMI Kosovës dhe partnerëve tjerë, të cilët jo gjithmonë kanë kapacitete të monitorojnë dhe inkurajojnë nëpunësit civilë komunalë të marrin pjesë siç do të kishte mundësi të e bëjë komuna përkatëse. Është vërejtur në përvojën e ECMI Kosovës se mungesa e mbështetjes institucionale për organizim të programeve të trajnimit apo kurseve nënkupton që baza financiare për organizimin e tyre nuk është e garantuar dhe vazhdimisht është e varur nga financimi dhe angazhimi i jashtëm. Ky fakt gjithashtu mund të e rrezikojë cilësinë e kurseve. Organizimi i vazhdueshëm i kurseve është çelësi i suksesit, por kjo varet edhe nga vullneti politik i qeverive komunale. Për më tepër, mësuesit e kualifikuar nuk janë të sigurtë të e bëjnë këtë punë pasi që ka mungesë të mjeteve financiare për të siguruar materialet e trajnimit relevante, që nënkupton që mësuesit duhet të përdorin materiale nga tekstet jo të specializuara.

Puna e ECMI Kosovës duhet të institucionalizohet brenda strukturave qeveritare në mënyrë që të përfitohet nga organizimi i kurseve përgjatë viteve 2011 - 2017. Me organizimin e këtyre kurseve, siç u përmend, ECMI Kosova ka arritur të ketë ngritje të njohurive gjuhësore të personave që kanë marrë pjesë dhe të cilët e kanë vlerësuar lartë këtë mundësi. Nga organizimi i këtyre kurseve, kanë përfitur mbi 1,000 nëpunës civilë komunalë. Megjithatë, ndikimi i organizimit të kurseve në përmirësimin e marrëdhënieve në mes të komuniteteve nuk mund të thuhet.

Hulumtimi i ECMI Kosovës i vitit 2010 ka gjetur që edhe pse 89% e nëpunësve civilë komunalë vlerësojnë lartë njohjen e gjuhëve zyrtare, kjo nuk reflekton në

kapacitetin e tyre aktual. Njohja e gjuhës Shqipe nga qytetarët që nuk e kanë këtë gjuhë si gjuhë amtare, ishte e ulët, ku 68% e tyre që janë përfshirë në hulumtim kishin njohuri bazike apo nuk kishin njohuri fare të kësaj gjuhe, dhe shumë pak prej tyre mund të thuhet që e njohin këtë gjuhë në nivel të kënaqshëm. Njohja e gjuhës Serbe nga qytetarët që nuk e kanë këtë gjuhë si gjuhë amtare, ishte më e lartë; megjithatë, vetëm 14% kishin njohuri të avancuar të gjuhës dhe 20% nuk kishin njohuri fare apo mund të thuhet që kishin njohuri shumë bazike, kurse 44% prej tyre kishin njohuri në nivel të kënaqshëm. Këto figura tregojnë që zbatimi i Ligjit për Përdorim të Gjuhëve në nivel lokal nuk është në nivel të duhur, dhe se masa të ndryshme duhet të ndërmerren në mënyrë që ky fakt të ndryshohet. Për më tepër, njohja e të dy gjuhëve zyrtare nga gjeneratat e reja dhe nënpunësit civilë komunalë është në nivel jo të kënaqshëm, duke reflektuar ndryshimet strukturore të arsimit gjatë viteve 1990. Këto fakte e mbështesin rëndësinë e organizimit të programeve të trajnimit apo kurseve nga institucionet në mënyrë që të e zvogëlojnë mundësinë e krijimit të “zbrazëtirave në gjenerata” nga të cilat mund të krijohet një moskomunikim në mes të nënpunësve civilë komunalë dhe komuniteteve, që do të ndikojë më pas negativisht në efikasitetin e qeverisë lokale. Pjesëmarrësit në organizimin e kurseve nga ECMI Kosova kanë shprehur interes dhe dëshirë të vazhdojnë të i përmirësojnë dhe ngrisin kapacitetet e tyre profesionale. Kjo tregon rëndësinë e organizimit të këtyre kurseve dhe se sa efektive mund të jenë nëse vazhdohen të organizohen në kuadër të komunave relevante.

ECMI Kosova për momentin është e angazhuar në procesin e përpilimit të materialeve të gjuhës Shqipe dhe Serbe të cilat do të përdoren për organizimin e kurseve gjuhësore për nënpunësit civilë komunalë. Kjo initiative mbështetet nga OSBE Komisioneri i Lartë i Pakicave Kombëtare. Grupi punues i cili është përgjegjës për përpilimin e këtij materiali përbëhet nga dy ekspertë të gjuhës Shqipe dhe dy të gjuhës Serbe të cilët kanë qenë të angazhuar në projektin e ECMI Kosovës në ofrimin e kurseve të gjuhës Shqipe dhe Serbe për nënpunësit civilë komunalë. Këto materiale do të përpilohen duke u bazuar gjithashtu në përvojën e ECMI Kosovës ndër vite e cila ishte e angazhuar në ofrimin e kurseve, dhe mendohet të kenë për qëllim të përmirësojnë komunikimin e atyre personave që punojnë në zyret komunale veçanërisht. Materialet do të përfshijnë apo do të fokusohen në punët e përditshme të nënpunësve civilë komunalë, duke shmangur fokusin e shtuar në gramatikë. Materialet do të publikohen për të ofruar kurse të niveleve A1, A2 dhe B1, ku për secilin nivel do të jenë nga tre (3) materiale/libra. Këto materiale/libra duhet të testohen para se të fillohet me organizim të kurseve dhe përdorim të tyre. Shpresohet që IKAP-I të i përdorë këto material gjatë procesit të institucionalizimit të kurseve gjuhësore në të ardhmen e afërt.

REKOMANDIMET

- Për të adresuar rritjen e njëgjuhësisë në komuna, është e domosdoshme që të ofrohen mundësi për të mësuar gjuhën e dytë zyrtare të shtetit dhe kjo mundësi duhet të ofrohen në formë të arsimit. Kjo përfshinë mësimin fillestar të gjuhës së dytë në moshë të re si dhe mësimin më të specializuar në nivel të univerzitetit (të dyja këto mundësi mungojnë në arsimin në gjuhën Shqipe dhe Serbe në Kosovë). Në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve 2016 dhe Kushtetutën e Kosovës, kërkohet njohuri më e madhe e të dy gjuhëve zyrtare në Shërbimit Civil të Kosovës, pavarësisht efektit pozitiv që do të ketë në përmirësimin e marrëdhënieve ndër-etnike. Duket paradoksale që Kosova është shtet dygjuhësor, dhe akoma deri sot as shkollat në gjuhën Shqipe as ato Serbe nuk mësojnë gjuhën tjetër zyrtare. Pa dyshim, kjo është një çështje e ndjeshme dhe nuk mund të zgjidhet brenda natës. Megjithatë, nevoja për të zgjeruar arsimin e gjuhës së dytë zyrtare duhet të jetë prioritet afatgjatë i Qeverisë së Kosovës. Për këtë arsye nxitja e ndërgegjegjësimit të rëndësishëm të mësimin të gjuhës, sidomos duke filluar me fëmijët e vegjël, duhet të inkurajohet me qëllim që Qeveria të bëjë një plan afatgjatë në lidhje me këtë çështje.
- Trajnime/kurse të gjuhës Shqipe dhe Serbe që ofrohen nga komunat e Kosovës duhet të institucionalizohen dhe zyrtarizohen
- Ministria e Administratës Publike duhet të krijojë një politikë për institucionalizimin e kurseve të gjuhës, e cila pastaj do të zbatohet nga IKAP-i. Ligji për IKAP-in tregon përgjegjësinë e këtij institucioni në ofrimin e programeve të trajnimit profesional të zyrtarëve që punojnë në institucionet në nivel qendrorë dhe lokalë.⁴⁹ Duke u bazuar në pilot projektin e ECMI Kosovës dhe përvojën e Zyrës së Komisionerit për Gjuhët, IKAP duhet të krijojë një paketë trajnimit për nëpunësit civilë e cila ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të tyre gjuhësore. Duhet të përpilohen një program i cili do të shoqërohet me materialin adekuat. Komunat mund të përdorin platformën e gjuhës Voc-Up të krijuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim, ZKGI dhe Qendra për Iniciativa Sociale në Mitrovicën e Veriut me financim nga Ambasada e Britanisë së Madhe.⁵⁰

⁴⁹ Ligji Nr. 04/L-221 për Institutin Kosovar për Administratë publike.

⁵⁰ <https://www.voc-up.com/>

- Zbatimi apo organizimi i kurseve të tilla, duhet të bëhet nga IKAP-it, i cili është institucion i themeluar nga Ministria e Administratës Publike. Aktualisht, IKAP-i është i mbingarkuar dhe nuk ka mjete financiare të mjaftueshme, dhe përpilimi dhe zbatimi i një programi të trajnimit për momentin mund të mos jetë në nivelin e duhur kështu që mund të mos jep rezultate efektive. Krijimi i një departamenti të ri brenda IKAP-it i cili do të mirret vetëm me organizime të trajnimeve gjuhësore mund të mundësojë një zbatim efektiv. Një departament i tillë mund të bashkëpunojë me ECMI Kosovën e cila mund të i ndajë të gjitha përvojat dhe mund të i jep drejtim dhe udhëzim se si të e bëjnë formulimin e një pakete të tillë trajnimi.
- Pjesëmarrja në këto kurse duhet të jetë në mënyrë vullnetare dhe këto trajnime duhet të organizohen gjatë orarit të punës. Për të inkurajuar nënpunësit civilë komunalë të marrin pjesë në këto trajnime, suksesi i pjesëmarrësve mund të pasqyrohet në vlerësimin e përgjithshëm të performancës së nënpunësit civil komunalë. Në afat më të gjatë, pjesëmarrja në kurse duhet të bëhet e detyrueshme të paktën për ato pozita të cilat janë kyçe në komunë. Gjithashtu konsiderohet se para fillimit të kurseve të tilla, komunat duhet të bëjnë një listë të individëve të cilët duhet të e ndjekin kursin dhe të jap informata se në çfarë kapaciteti ata punojnë. Kjo do të ndihmonte në monitorimin e pjesëmarrjes së kursit. Gjithashtu, kurset e gjuhës do të mbahen edhe për ata nënpunës civilë komunalë që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët.
- Kurset do të duhet të përdorin materialet/librat e gjuhës Shqipe dhe Serbe të cilat momentalisht janë në fazën pregaditore nga ECMI Kosova. Këto materiale do të përmbushin nevojat e identifikuar dhe shtjellojnë terminologjinë me të cilën ballafaqohen nënpunësit civilë në punën e tyre të përditshme. Materialet janë duke u përpiluar duke e marrë parasysh gjithashtu përvojën e ECMI Kosovës e cila ishte e angazhuar në ngritjen e kapaciteteve gjuhësore të Shërbimit Civil nga viti 2010 deri në vitin 2017. Këto material duhet të testohen para së të fillojë përdorimi i tyre; sygjerohet që IKAP-i të e bëjë të njejtën në të ardhmen e afërt në konsultim të vazhdueshëm me ECMI Kosovën.
- Ministria e Administratës Publike duhet të prezantojë një standard të analizimit të njohurive gjuhësore për vlerësimin dhe certifikimin e niveleve të njohurive gjuhësore që do të njihen në pranimin e punëtorëve të rinjë në shërbimin publik ose që do të shërbejë për të përcaktuar nevojën për trajnime të ngritjes së kapaciteteve gjuhësore. ZKGJ ka treguar se aktualisht

është në proces të prodhimit të një vlerësimi të tillë për pozitat të cilat mendohet se duhet njohuria e dy gjuhëve zyrtare në Shërbimit Civil.⁵¹ Aktualisht, shumica e aplikantëve dhe punonjësve brenda sektorit publik duhet të "vlerësojnë vet" aftësitë e tyre gjuhësore, gjë që shfaq shqetësime për shkak të mbivlerësimeve të bëra vetëm që të fitohet një vend i punës apo të përparojnë në karrierë/pozitë. Për këtë arsye, projekti i ZKGJ duhet të mbështetet nga të gjitha palët relevante dhe të zbatohet sa më shpejt në institucionet në nivel komunal.

- Nevoja për mbështetjen e organizimit të kurseve nga hierarkitë brenda secilës komunë është shumë me rëndësi. Në përvojën e ECMI Kosovës, është vërejtur se në komunat ku janë përfshirë drejtorët dhe punëtorët që kishin pozita më të larta në administratën komunale ka luajtur rol në nxitjen e pjesëmarrjes dhe në mbajtjen e vijueshmërisë së kurseve gjuhësore. Mund të thuhet që kurset e tilla kanë pasur rezultate më pozitive sesa kur nuk kishte ndonjë përfshirje të personave me pozita më të larta në komuna. Institucionalizimi i mësimi të gjuhëve në nivel komunal do të sillte përfitime në mënyrë të konsiderueshme nëse do të ishte mbështetja nivelit më të lartë në komunë.
- Organizimi nga vet institucioni i kurseve të gjuhës duhet të ndjekë një strukturë strategjike afatgjatë me qëllim që të nxisë rezultatet më të mira. Kurset e gjuhës të organizuara nga ECMI Kosova nga viti 2011 deri më 2017 janë bërë në baza vjetore. Për çdo vit, ECMI Kosova ka qenë e obliguar të e bëjë kërkesën për financim nga KLPK dhe ZKGJ. Ky fakt ndonjëherë pengonte vazhdimin e menjëhershëm të kurseve, pasi që koha deri në aprovim të projektit ishte e gjatë dhe pastaj ishte e detyrueshme të organizohen kurse të përshpejtuara që të e përmbledhim programin e propozuar. Kështu që, kishte më pak kohë për përkushtim tek arritjet e secilit pjesëmarrës. Për më tepër, ky fakt gjithashtu ka krijuar vështirësi në pjesëmarrjen e vazhdueshme të individëve, ku disa nuk kanë shprehur dëshirë për të vazhduar, ose disa të tjerë nuk ishin duke punuar më në komunë. Institucionalizimi i ofrimit të kurseve të gjuhëve do të bënte që objektivat afatgjata të ndiqeshin, gjë që duhet të merret në konsideratë nga IKAP-i, dhe siç rekomandohet, të fillojë me organizimin e kursve të gjuhëve.
- Njohja e dy gjuhëve nuk do të duhej të ishte kërkesë në procesin e punësimit për shumë nënpunës civilë komunalë, pasi që kjo do të ndikojë direkt në zvogëlimin e mundësive të punësimit për ata persona të cilët nuk i flasin të dy

⁵¹ Intervistë me Komisionerit për Gjuhët Z. Slaviša Mladenović, tetor 2018.

gjuhët zyrtare. Gjuha mbetet të jetë një çështje jashtëzakonisht e ndjeshme në tërë Kosovën, dhe nëse kemi një kërkesë të tillë, marrëdhëniet ndër-etnike nëpër komuna do të mund të rrezikohen. Për më tepër, duke pasur parasysh nivelet relativisht të ulëta të njohjes së të dy gjuhëve zyrtare, veçanërisht nga brezave të rinj në Kosovë, vendosja e një kërkesë të tillë është disi joreale. Gjithashtu, ky fakt do të mund të zvogëlojë cilësinë, duke përfituar aplikantët të cilët kanë njohuri të të dy gjuhëve, kurse duke i përjashtuar ata që kanë pregaditje më të mirë akademike dhe profesionale dhe janë më të përshtatshëm për pozitën në fjalë. Në vend të vendosjes së këtij kriteri, stimuluesit në formë monetare mund të prezantohen, ku ata persona që i flasin të dy gjuhët, do të marrin kompensim në formë të parave. Kjo mund të del nga një program i cili do të jetë si stimulues dhe do të shpërblejë ata persona që i flasin të dy gjuhët zyrtare. Programi i testimit të certifikuar për aftësitë gjuhësore nga ZKGJ do të jetë gjithashtu vendimtare për inkurajimin e dygjuhësisë brenda institucioneve komunale, pasi që do të vendosë një pikë referimi për aftësitë aktuale të gjuhës midis nëpunësve civilë komunalë.

LITERATURA

Udhëzimi Administrativ në Përcaktimin e Procedurave për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve [MAPL UA Nr. 2007/06]

Kushtetuta e Kosovës

<http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

Këshilli i Evropës, Nxitja e Përshtatjes përmes Arsimit për Demokraci dhe Mësim Gjuhësor, <https://rm.coe.int/fostering-rapprochement-through-education-for-democracy-and-language-l/16808e8be1>

Vendimi I Zyrës së Kryeministrit Nr 251/2018, 16 gusht 2018

Raporti I ECMI Kosovës në Kompetencat gjuhësore të Nënpunësve Civil, 2010

Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve

Komisioni Evropian, Kosova Raporti i Progresit 2016

Ministria finlandeze e Drejtësisë, Akti mbi Njohjen e Gjuhëve të Kërkuara të Personelit në Organet Publike Nr. 424/2003

Ministria e Drejtësisë së Finlandës, Plani i Veprimit për Strategjinë për Gjuhët Kombëtare të Finlandës, 28 shkurt 2017

Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare <http://officiallanguages.nb.ca/faq>

<http://www.efnil.org/documents/conference-publications/london-2011/the-role-of-language-education-in-creating-a/15-Pirkko-Nuolijarvi.pdf>

<http://www.officiallanguages.gc.ca/en/timeline-event/bilingualism-bonus-federal-public-servants-introduced>

<https://portal.cor.europa.eu/divisionpowers/countries/membersLP/Belgium/Pages/default.aspx>

<https://www.admin.ch/opc/en/classified-compilation/20062545/20170101000/441.1.pdf>

<https://www.uottawa.ca/clmc/internationalperspective/switzerland>

<https://www.voc-up.com/>

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike

Ligji për Komunitete

Ligji për Institutin e Kosovës për Administratë Publike [Nr. 04 / L-221]

Ligji për Shërbimin Civil të Kosovës [Ligji Nr. 03 / L-149]

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Nr. 02 / L-37]

http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2006_02-L37_en.pdf

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Nr. 02 / L-37]

http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2006_02-L37_en.pdf

Zyra për Çështje të Komuniteteve / ECMI Kosovë, Studimi i Politikave I: Punësimi i Pjesëtarëve të Komuniteteve Jo-Shumicë në kuadër të Shërbimit Civil të Kosovës dhe Ndërmarrjeve Publike

Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKL) / Zyra e Kryeministrit (2015). Monitorimi dhe Vlerësimi i të Drejtave të Gjuhëve në Kosovë

http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/Anglisht_Final_160315.pdf

OSBE (2012), Legjislacioni shumëgjuhësh në Kosovë dhe sfidat e tij <https://www.osce.org/kosovo/87704?download=true>

OSCE (2015), Pajtueshmëria e Gjuhëve të Komunave në Kosovë <https://www.osce.org/kosovo/120010?download=true>

Dokumenti i Kopenhagës i OSBE

Rekomandimet e OSBE-së në Oslo

Plani i veprimit për periudhën trevjeçare 2016-2018 për Zbatimin e Strategjisë për Trajnimin e Nënpunësve Civilë 2016-2020, <https://map.rks-gov.net/getattachment/649247f0-f60a-4fd0-aae6-30ab39c933ac/.aspx>.

Rregullorja 07/2012 për Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve

Deklarata e OKB-së mbi të Drejtat e Personave që i përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore

ERAC

EQUAL RIGHTS FOR ALL COALITION



 European
Union
Kosovo